

PHILIPS

AVENT

SCF883, SCF885



Manuali i përdorimit

Përmbajtja

E rëndësishme	3
Sistemet e sigurisë	8
Fushat elektromagnetike (EMF)	8
Hyrje.....	8
Përshkrim i përgjithshëm	9
Përpara përdorimit të parë.....	10
Përdorimi i pajisjes	11
Mbushja e depozitës së ujit.....	12
Gatimi me avull.....	13
Përzierja pas avullimit	16
Përzierja pa avull	18
Ringrohja	21
Shkrirja	24
Përbërësit dhe koha e avullimit	26
Pastrimi dhe deskorjezimi	27
Pastrimi	27
Zhgëlqerëzimi i depozitës së ujit.....	29
Vendruajtja	30
Riciklimi.....	30
Mbështetja.....	30
Zgjidhja e problemeve	31
Specifikimet teknike	35

E rëndësishme

Lexojeni me kujdes këtë manual përdorimi përpara se ta vini në punë pajisjen, si dhe ruajeni për referencë në të ardhmen.

Rrezik

- Mos e zhytni kurrë njësinë kryesore në ujë apo në ndonjë lëng tjetër. Mos e shpëlani me ujë rubineti.

Paralajmërim

- Kontrolloni nëse tensioni i treguar në pajisje përkon me tensionin e rrjetit elektrik lokal përpara se ta lidhni pajisjen.
- Mos e përdorni pajisjen nëse spina, kordoni elektrik apo pajisja vetë është e dëmtuar. Nëse kordoni elektrik është i dëmtuar, ai duhet ndërruar nga "Philips", nga një pikë shërbimi e autorizuar nga "Philips" ose nga persona me kualifikim të ngjashëm, në mënyrë që të shmangni rreziqet.
- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë me aftësi të reduktuara fizike, shqisore apo mendore, apo që kanë mungesë përvoja dhe njohurish vetëm nëse u kushtohet mbikëqyrja e duhur apo u jepen udhëzime në lidhje me përdorimin e sigurt të pajisjes, si dhe nëse kuptojnë rreziqet e përfshira.
- Fëmijët nuk duhet të luajnë me pajisjen (duke përfshirë aksesoret).
- Kjo pajisje nuk duhet përdorur nga fëmijët. Mbajeni pajisjen dhe kordonin larg vendeve ku mund të arrihet nga fëmijët (duke përfshirë aksesoret).
- Pastrimi dhe mirëmbajtja nga përdoruesi nuk duhen kryer nga fëmijët.
- Mos i prekni tehet, sidomos kur pajisja është e futur në prizë. Tehet janë shumë të mprehta.
- Bëni kujdes kur manovroni helikën e mprehtë, kur zbrazni kanën dhe gjatë pastrimit.


- Nëse helika ngec, shkëputeni pajisjen përpara se të hiqni përbërësit që kanë bllokuar helikën.
- Pajisja nxehet gjatë apo pak pas avullimit (sidomos sipërfaqet me simbolin “) dhe mund të shkaktojë djegie kur preket. Ngrijeni kanën vetëm duke e kapur nga doreza.
- Nga kana del avull i nxehtë gjatë avullimit dhe kur hiqet kapaku.
- Bëni kujdes nga avulli i nxehtë që del nga depozita e ujit kur i hapni kapakun.
- Kur mbaron cikli i avullimit, do të vazhdojë të dalë avull i nxehtë për një farë kohe nga dalja e avullit në kapakun e depozitës së ujit dhe vrima e avullit në kanë. Bëni kujdes kur hiqni kanën nga njësia kryesore.
- Nëse pajisja përdoret në mënyrë të papërshtatshme, mund të çlirohet avull i nxehtë nga buzët e kapakut të depozitës së ujit. Shihni kapitullin “Diagnostikimi” për parandalimin apo zgjidhjen e kësaj.
- Bëni kujdes të veçantë kur hidhni lëng të nxehtë në kanë, pasi mund të nxjerrë stërkala.
- Gjithnjë hidhni ushqimin e përzier më parë në enën ruajtëse nëse doni të ringrohni apo shkrini ushqim me këtë pajisje.
- Mos e përdorni këtë pajisje për të prerë përbërës të fortë dhe ngjitës.
- Mos përdorni kurrë klor apo solucione sterilizimi kimik/tableta në pajisje.
- Mos përdorni kurrë sfungjerë gërvishtës, solucione abrazive apo lëngje ose lëngje agresive si p.sh. benzinë, aceton apo alkool për të pastruar pajisjen.
- Lëreni gjithnjë pajisjen të ftohet për 10 minuta pas një cikli avullimi përpara se të filloni sërish avullimin.

- Mos e lini pajisjen të përziejë për më shumë se 30 sekonda për rast. Nëse nuk keni mbaruar përzierjen pas 30 sekondave, lëshoni butonin për të ndaluar përzierjen dhe prisni pak sekonda përpara se të vazhdoni. Nëse njësia kryesore bëhet e nxehtë, lëreni të ftohet për disa minuta para se të vazhdoni.
- Asnjëherë mos vendosni ujë apo ndonjë lëng tjetër në kanë për avullim, për të shmangur dëmtimin e pajisjes.
- Gjithmonë hiqni kapakun e enës ruajtëse para se të përdorni enën për të ngrohur ushqimin në mikrovalë.

Kujdes

- Mos përdorni kurrë aksesore apo pjesë nga prodhues të tjetër apo që nuk rekomandohen konkretisht nga "Philips". Nëse përdorni aksesore apo pjesë të tilla, garancia juaj bëhet e pavlefshme.
- Mos e vendosni pajisjen mbi apo pranë një sobe apo tenxhereje në punë apo ende të nxehtë.
- Fikeni gjithnjë pajisjen dhe hiqeni nga priza nëse nuk ka mbikëqyrje, si dhe përpara mbërthimit, zbërthimit, ndërrimit të aksesoreve, pastrimit apo avitjes ndaj pjesëve lëvizëse në përdorim.
- Hiqeni gjithnjë pajisjen nga priza dhe lëreni të ftohet përpara se ta pastroni.
- Gjithmonë kthejeni çelësin e kontrollit në pozicionin e fikjes (**OFF**) çdo herë pas avullimit, ringrohjes ose shkrirjes.
- Asnjëherë mos e përdorni kanën apo ndonjë pjesë tjetër të pajisjes (përveç enëve ruajtëse) në mikrovalë, pasi pjesët metalike të dorezës së kanës dhe të helikës nuk janë të përshtatshme për këtë përdorim.
- Asnjëherë mos e sterilizoni kanën ose ndonjë pjesë tjetër të pajisjes (përveç enëve ruajtëse) në sterilizues apo mikrovalë, pasi pjesët metalike të dorezës së kanës dhe të helikës nuk janë të përshtatshme për këtë përdorim.

- Kjo pajisje synohet vetëm për përdorim shtëpiak. Nëse pajisja përdoret në mënyrë të papërshtatshme apo për qëllime profesionale ose gjysmë-profesionale apo nuk përdoret sipas udhëzimeve në këtë manual përdorimi, garancia bëhet e pavlefshme dhe "Philips" refuzon çdo lloj përgjegjësie për dëmin e shkaktuar.
- Vëreni pajisjen mbi një sipërfaqe të qëndrueshme, horizontale dhe të rrafshët. Pajisja lëshon avull të nxehtë gjatë përdorimit. Sigurohuni që të ketë hapësirë të mjaftueshme të lirë përreth për të parandaluar dëmtimin e mobilieve apo të sendeve të tjera.
- Mos e përdorni pajisjen nëse është rrëzuar apo ka pësuar ndonjë dëmtim. Dërgojeni për riparim te një pikë servisi e autorizuar nga "Philips".
- Asnjëherë mos e përdorni funksionin e avullit pa ujë në depozitën e ujit.
- Hiqeni gjithmonë pajisjen nga priza nëse mbetet pa mbikëqyrje.
- Sigurohuni që uji në depozitë të mos tejkalojë shenjën MAX të nivelit të ujit në anën e depozitës së ujit (250 ml) ose treguesin MAX të nivelit të ujit në depozitën e ujit.
- Sigurohuni që kapaku i depozitës së ujit të jetë mbyllur saktë para se të vendosni kanën në njësinë kryesore.
- Kur të përgatisni përbërësit me avull, sigurohuni që të mos e mbushni kanën përtej pjesës së sipërme prej plastike të njësisë së teheve.
- Kur përzieni lëngje, mos e tejkaloni nivelin **MAX** të mbushjes të treguar në kanë (720 ml).
- Mos e ngrini dhe lëvizni pajisjen kur është duke punuar.
- Mos futni asnjë send në daljen e avullit në kapakun e depozitës së ujit ose hyrjen e avullit në kapakun e kanës.
- Asnjëherë mos e mbushni depozitën e ujit gjatë avullimit, pasi mund të dalë ujë i nxehtë dhe avull nga pajisja.



- Gjithmonë sigurohuni që kapaku i kanës të jetë ftohur pas avullimit para se ta hapni për të shtuar më shumë përbërës për përzierje.
- Asnjëherë mos e vendosni pajisjen në prizë përmes stakuesve të jashtëm si p.sh. me kronometër apo në qarqe që stakohen dhe takohen rregullisht.
- Gjithmonë kontrolloni temperaturën e ushqimit të gatuar në shpinën e dorës suaj për t'u siguruar që është i sigurt për fëmijën tuaj.
- Gjithmonë kontrolloni konsistencën e ushqimit për fëmijën tuaj. Për udhëzime se cilat konsistenca ushqimore janë të përshtatshme për mosha të ndryshme, referojuni këshillave profesionale për largimit e fëmijës nga që vijnë me këtë pajisje, ose kërkoni këshillën e mjekut ose të konsultores.
- Përdorni vetëm shpatullën e dhënë për nxjerrjen e ushqimit nga kana.
- Zhgëlqerëzimi i rregull parandalon dëmtimin e pajisjes.
- Ena ruajtëse që vjen me këtë pajisje nuk është mjet për ushqyerjen e fëmijëve. Mos i ushqeni fëmijët direkt nga ena ruajtëse.
- Para se të përdorni enën ruajtëse, pastrojeni plotësisht dhe më pas sterilizojeni me një sterilizues Philips Avent ose vendoseni enën ruajtëse në ujë të vluar për 5 minuta. Kjo është për të siguruar higjienën. Sigurohuni që të ketë ujë të mjaftueshëm në kanë kur përdorni ujë të vluar për të sterilizuar enën ruajtëse dhe që ena të mos takojë kanën për një kohë të gjatë, për të shmangur deformimin nga nxehtësia.
- Sigurohuni që sasia e ushqimit në enën ruajtëse të mos kalojë nivelin maksimal të shënuar në anën e enës, përndryshe ena mund të derdhet.
- Kur ringrohni ose shkrini ushqimin, sigurohuni që kapaku i enës ruajtëse të jetë i mbyllur fort para se ta vendosni enën ruajtëse në kanë, përndryshe ena mund të rrjedhë kur ta nxirrni nga kana.

- Ngrohja e ushqimit me enën e dhënë ruajtëse në mikrovalë mund të gjenerojë temperatura të larta të lokalizuara në ushqim dhe mund të ndikojë në vlerën e tij ushqyese. Gjithmonë trazojeni ushqimin e nxehtë për të siguruar shpërndarje të njëtrajtshme të nxehtësisë dhe për të provuar temperaturën para se ta servirni ushqimin.
- Mos zgjidhni funksionin e skarës nëse përdorni një mikrovalë të kombinuar (me funksionin e skarës) për të ringrohur ose shkrirë ushqimin me enët ruajtëse. Nëse sapo keni mbaruar një proces skare, prisni derisa mikrovala të jetë ftohur para se të vendosni enë ruajtëse në të, pasi nxehtësia e mbetur mund të shkaktojë dëme në enët ruajtëse.

Sistemet e sigurisë

Për sigurinë tuaj gjatë përdorimit, kjo pajisje është e pajisur me një siguresë të integruar. Kjo pajisje do të funksionojë vetëm nëse të gjitha pjesët janë montuar saktë. Montimi i saktë i të gjitha pjesëve do të çaktivizojë siguresën e integruar.

Kjo pajisje është gjithashtu e pajisur me një funksion ndalimi sigurie nga mbinxehja. Mbinxehja mund të ndodhë nëse koha midis dy cikleve të avullimit është shumë e shkurtër. Nëse ndalimi i sigurisë nga mbinxehja i pajisjes aktivizohet gjatë një cikli avullimi, kthejeni çelësin e kontrollit përsëri në pozicionin e fikjes (**OFF**) dhe lëreni pajisjen të ftohet për disa minuta. Pas kësaj, mund ta përdorni përsëri pajisjen.

Fushat elektromagnetike (EMF)


Kjo pajisje "Philips" pajtohet me të gjitha standardet dhe rregulloret në fuqi për ekspozimin ndaj fushave elektromagnetike.

Hyrje

Urime për blerjen dhe mirë se vini pranë Philips Avent! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që ofron "Philips Avent", regjistroni produktin në faqen www.philips.com/welcome.

Ky prodhues ushqimi të shëndetshëm për foshnja 4-në-1 ndihmon të gjithë prindërit në përgatitjen e vakteve ushqyese për foshnjat e tyre me funksione avullimi dhe përzierjeje të kombinuara në një pajisje. Prodhuesin e ushqimit për foshnja mund ta përdorni dhe për të shkrirë dhe ngrohur ushqimin për foshnja.

Përshkrim i përgjithshëm



Përmbledhje e produktit			
A	Veshi i kapakut	K	Shenjat e nivelit të ujit
B	Bashkuesi në kapakun e kanës	L	Treguesi MAX i nivelit të ujit
C	Kapaku i kanës	M	Depozita e ujit (nuk hiqet)
D	Gomina	N	Bojleri
E	Kunj sigurimi	O	Njësia kryesore
F	Sita	P	Çelësi i kontrollit
G	Helika	Q	Butoni i përzierjes
H	Mbajtësja e helikës	R	Kordoni elektrik
I	Kana	S	Zona e kycjes në depozitën e ujit
J	Kapaku i depozitës së ujit		
Përmbledhje e komandave			
T	Cilësimi i shkrirjes	V	Cilësimi i ringrohjes për enën ruajtëse 120 ml
U	Cilësimi i ringrohjes për enën ruajtëse 240 ml	W	Llamba e avullimit
Aksesorët			
X	Ena ruajtëse	Z	Shpatulla
Y	Kapaku i enës ruajtëse		

Përpara përdorimit të parë

- 1 Hiqni të gjithë materialin e paketimit nga pajisja.
- 2 Pastrojeni të gjitha pjesët mirë përpara përdorimit për herë të parë. Shihni kapitullin "Pastrimi dhe heqja e çmërsit".
- 3 Rekomandojmë të kryeni një cikël avullimi me kanën bosh përpara se të përdorni pajisjen për herë të parë. Shihni kapitujt "Mbushja e depozitës së ujit" dhe "Avullimi".

Përdorimi i pajisjes



Kujdes

- Gjithmonë kontrolloni temperaturën e ushqimit të gatuar në shpinën e dorës suaj për t'u siguruar që është i sigurt për fëmijën tuaj.

Kjo pajisje është menduar për avullimin e përbërësve të freskët, të ngurtë dhe përzierjen e tyre deri në trashësinë e zgjedhjes suaj. Shihni broshurën shoqëruese me receta për ide recetash të shijshme dhe plotë me vlera ushqyese. Pajisja mund të përdoret gjithashtu vetëm për avullim ose vetëm për përzierje. Për përdorimin vetëm për përzierje, shihni kapitullin "Përzierja pa avullimin".

Kjo pajisje mund të përdoret gjithashtu për të shkrire ose ngrohur përsëri ushqimet e gatuar që janë ruajtur në enë ruajtëse të posaçme. Përdorni gjithmonë këto enë ruajtëse për të shkrire ose ngrohur përsëri ushqimet e përziera. Shkrija ose ringrohja pa enët ruajtëse do të bëjë që ushqimi të bjerë përmes sitës në kapakun e kanës.

Asnjëherë mos e vendosni kanën me ushqim të përzier brenda në pozicionin e avullimit në njësinë kryesore.

Asnjëherë mos avulloni të njëjtin grup përbërësish të pagatuar për më shumë se 30 minuta ose më shumë se një herë.

Kjo pajisje NUK është menduar për qëllimet e mëposhtme.



- Avullimin e përbërësve të pagatuar të ngrirë
- Avullimin e ushqimit të përzier më parë pa enë ruajtëse
- Avullimin e përbërësve të njëjtë për më shumë se 30 minuta
- Gatimin e orizit dhe të makaronave
- Përzierjen përpara dhe pastaj avullimin
- Ngrohjen apo ringrohjen e lëngjeve si supat, salcat apo uji
- Mbajtjen e ushqimit të ngrohtë për disa orë
- Prerjen e përbërësve të fortë si kubikë akulli dhe kubikë sheqeri apo të përbërësve ngjitës si djathi

Mbushja e depozitës së ujit


Shënim

- Sigurohuni që uji në depozitë të mos tejkalojë shenjën MAX të nivelit të ujit në anën e depozitës së ujit (250 ml) ose treguesin MAX të nivelit të ujit në depozitën e ujit.
- Rekomandojmë që të përdorni ujë të butë ose të demineralizuar, pasi mineralet në ujin mineral apo në ujin e rubinetit mund të shpejtojnë krijimin e çmërsit brenda depozitës së ujit.
- Përveç materialeve të nevojshme për zhgëlqerëzim, mos vendosni kurrë lëngje të tjera përveç ujit në depozitën e ujit.

- 1** Kthejeni kapakun e depozitës së ujit në drejtim kundërorar për të hapur depozitën e ujit, më pas ndiqni shenjat e nivelit të ujit në depozitën e ujit dhe mbusheni këtë të fundit deri në nivelin e kërkuar sipas kapitullit "Përbërësit dhe koha e avullimit" në manualin e përdorimit ose në broshurën shoqëruese me receta.



- 2** Vendosni kapakun në depozitën e ujit dhe kthejeni atë në drejtimin orar për ta fiksuar mirë në vend.



- ↳ Kur kapaku i depozitës së ujit është i mbërthyer siç duhet në vend, ikona ▲ në kapakun e depozitës së ujit do të drejtvendoset me ikonën 🔒 në depozitën e ujit.

Shënim


-  Sigurohuni gjithmonë që ta keni mbyllur kapakun e depozitës së ujit para se pajisja të fillojë të funksionojë.

Gatimi me avull



Kujdes


- Avulli i nxehtë ose uji i nxehtë mund t'ju djegë gishtat. Mos prekni dhe mos lejoni kurrë që fëmijët të prekin ndonjë pjesë të nxehtë të pajisjes ose avullin që del nga sipër pajisjes, pasi mund të përvëloheni.




Shënim

- Gjithmonë shkrihi përbërësit e pagatuar të ngrirë para se t'i vendosni në kanë për avullim. Shkundni ujin e mundshëm të tepërt nga përbërësit e shkrire para se t'i vendosni në kanë.
- Mos e mbushni përtej buzës së sipërme të pjesës plastike të helikës kur shtoni përbërës.
- Asnjëherë mos vendosni ujë apo ndonjë lëng tjetër në kanë për avullim, për të shmangur dëmtimin e pajisjes.
- Pajisja nuk fillon avullimin nëse kana nuk është mbyllur saktë në vend.
- Sigurohuni që gomina të jetë montuar rreth kapakut të kanës para procesit të avullimit dhe që ana e sheshtë e gominës të jetë nga jashtë.


- 1** Shtyni veshin e kapakut në drejtim kundërorar për të hequr kapakun nga kana.




- 2** Nëse njësia e teheve nuk është në kanë, futeni atë në mbajtësen e njësisë së teheve në kanë.




- 3** Rekomandojmë që përbërësit e fortë të priten në copa të vogla (kuba jo më të mëdhenj se 1 cm).
- 4** Vendosni përbërësit në kanë.



- 5** Shtypni sitën në kapakun e kanës.




- 6** Vendosni kapakun në kanë dhe kthejeni atë në drejtim orar për ta mbyllur atë mirë.



Shënim

- Kana ka vjaska që ndihmojnë në drejtimin e duhur të kunjave fiksuese dhe puthitjen e kapakut në vend. Sigurohuni që veshi i kapakut të rrëshqasë në dorezën e kanës.




- 7** Nëse nuk e keni mbushur ende depozitën e ujit me ujë për procesin e avullimit, shihni kapitullin "Mbushja e depozitës së ujit" dhe shtoni ujë në depozitë përpara se të vendosni kanën në njësinë kryesore.




Shënim

- Sigurohuni që kapaku i depozitës së ujit të jetë mbërthyer mirë para se të vendosni kanën në njësinë kryesore.


- 8** Ktheni kanën përmbysë me kapakun e saj në pjesën e poshtme.



- 9** Drejtvendosni bashkuesin në kapakun e kanës me zonën e mbërthimit në depozitën e ujit dhe më pas vendoseni kanën në njësinë kryesore me kapakun në pjesën e poshtme. Shtyni kanën poshtë për ta mbërthyer atë fortë në njësinë kryesore dhe sigurohuni që doreza të jetë në anën e djathtë.




- 10** Nëse çelësi i komandimit nuk është në pozicionin e fikjes (**OFF**), fillimisht kthejeni atë në pozicionin e fikjes.
- 11** Futni pajisjen në prizë.
- 12** Rrotulloni çelësin e komandimit për të zgjedhur kohën e avullimit që ju nevojitet. Për kohën e rekomanduar të avullimit shihni tabelën në kapitullin "Përbërësit dhe koha e avullimit" dhe broshurën me receta.



- ➔ Drita e avullimit  do të bëhet e bardhë për të treguar se pajisja po lëshon avull.
- ➔ Kur cikli i avullimit të ketë përfunduar, pajisja do të lëshojë një sinjal zanor dhe drita e avullimit do të fiket.

- 13** Kthejeni sërish çelësin e komandimit në pozicionin e fikjes (**OFF**). Përpara se të hiqni kanën, prisni 2 minuta ose derisa nga pjesa e sipërme e pajisjes të mos dalë më avull.



Kujdes

- Nëse keni ndërmend të filloni një cikël tjetër avullimi, lëreni pajisjen të ftohet për 10 minuta dhe zbrazni ujin që mund të ketë mbetur në depozitën e ujit përpara se ta rimbushni dhe të filloni një cikël të ri avullimi.

- 14** Për të përzierë përbërësit e përgatitur në avull, shihni kapitullin "Përzierja pas avullimit".


- 15** Mund të ketë ende ujë të mbetur në depozitën e ujit pas një cikli avullimi. Kjo është normale. Prisni derisa pajisja të ftohet në temperaturë ambiente, më pas zbrazeni të gjithë ujin e mbetur nga depozita. Për të zbrazur ose për të pastruar depozitën e ujit, shihni kapitullin "Pastrimi dhe heqja e çmërsit".

Përzierja pas avullimit




Kujdes


- Kana dhe kapaku do të nxehen pas ciklit të avullimit. Mbajeni kanën vetëm nga doreza e posaçme nxehtësiduruese.
- Gjithmonë sigurohuni që kapaku i kanës të jetë i mbyllur dhe i fiksuar mirë në vend ndërsa pajisja është në përdorim.
- Gjithmonë sigurohuni që kapaku i kanës të jetë ftohur pas avullimit para se ta hapni për të shtuar më shumë përbërës (mos e mbushni kanën deri në buzën e sipërme të pjesës plastike të helikës) ose për të hequr ujin e mbetur nga kana.
- Nëse keni shtuar lëngje shtesë, kurrë mos e vendosni kanën në pozicionin e avullit, pasi lëngu do të kalojë nëpër sitë.



- 1** Nga pozicioni i avullimit, ngrini kanën nga doreza dhe kthejeni atë përmbys. Tundeni kanën për të lejuar përbërësit e përgatitur në avull që të kalojnë në pjesën fundore të kanës, aty ku ndodhen tehet përzierëse.




- 2** Nëse është e nevojshme, hiqni kapakun e kanës dhe shtoni më shumë përbërës për përzierje (p.sh. ujë për puretë ose përbërës shtesë të gatuar, si p.sh. oriz ose makarona). Vendosni kapakun e kanës përsëri në kanë përpara se të filloni përzierjen.
- 3** Vendosni kanën në njësinë kryesore me kapakun në pjesën e sipërme, drejtvendosni ikonën  në kanë me ikonën  në njësinë kryesore dhe kthejeni kanën në drejtim orar për ta mbërthyer atë mirë në njësinë kryesore. Sigurohuni që doreza të jetë në anën e djathtë.



→ Kur kana të jetë mbërthyer siç duhet në njësinë kryesore, ikona  në kanë do të drejtvendoset me ikonën  në njësinë kryesore.


- 4** Shtypni dhe mbani shtypur butonin e përzierjes për të filluar përzierjen, derisa përbërësit të jenë në trashësinë që dëshironi.



Kujdes

- Mos e lini pajisjen të përziejë për më shumë se 30 sekonda për rast. Nëse nuk keni mbaruar përzierjen pas 30 sekondave, lëshoni butonin për të ndaluar përzierjen dhe prisni pak sekonda përpara se të vazhdoni. Nëse njësia kryesore bëhet e nxehtë, lëreni të ftohet për disa minuta para se të vazhdoni.

5 Kur të keni përfunduar përzierjen, lëshoni butonin e përzierjes.



6 Hiqeni pajisje nga priza.

7 Hiqeni njësinë e teheve. Bëni kujdes kur hiqni helikën pasi mund të jetë e nxehtë. Hiqni ushqimin e përzier nga kana. Nëse është e nevojshme, përdorni shpatullën e përfshirë me këtë pajisje.

Përzierja pa avull

Kjo pajisje synohet për qëllimet e mëposhtme.

- Përgatitja e pureve me përbërës të përgatitur në avull dhe përbërës të gatuar
- Përzierja e lëngjeve dhe frutave



Kujdes


- Pajisja nuk synohet për prerjen e përbërësve të fortë, si p.sh. kuba akulli dhe sheqeri apo për përbërës të ngjitshëm si djathi.
- Nëse keni shtuar lëngje në kanë, kurrë mos e vendosni kanën në pozicionin e avullit, pasi lëngu do të kalojë nëpër sitë.



Shënim


- Kur përzieni përbërësit me lëngje, sigurohuni që të mos e mbushni kanën përtej nivelit **MAX** të mbushjes të treguar në kanë.
- Mos e mbushni përtej buzës së sipërme të pjesës plastike të helikës kur shtoni përbërës.
- Asnjëherë mos e vendosni kanën me ushqim të përzier brenda në pozicionin e avullimit në njësinë kryesore.
- Nëse përbërësit ngjiten në murin e kanës ose nëse përbërësit e përzier janë akoma shumë të ngurtë, lëshoni butonin e përzierjes, hiqni kanën nga njësia kryesore dhe lironi përbërësit me shpatull ose shtoni pak lëng (p.sh. ujë të pijshëm) derisa ushqimi i përzier të ketë konsistencën e duhur për moshën e foshnjës tuaj. Kur shtoni lëngje në kanë, mos e mbushni kanën përtej nivelit **MAX** të mbushjes të treguar në kanë.
- Sigurohuni që ushqimi i përzier për foshnjën të ketë trashësinë e duhur para se ta shërbeni atë. Për udhëzime se cilat konsistenca ushqimore janë të përshtatshme për moshën të ndryshme, referojuni këshillave profesionale për largimit të fëmijës nga që vijnë me këtë pajisje, ose kërkoni këshillën e mjekut ose të konsultores.
- Mos përpunoni sasi të mëdha të përbërësve të ngurtë në të njëjtën kohë. Përpunojini këta përbërës në grupe tufash të vogla për të marrë një teksturë më të imët.

- 1** Vendosni njësinë e teheve në mbajtësen e njësisë së teheve në kanë.




- 2** Pritini përbërësit e fortë në copa të vogla (kubikë jo më të mëdhenj se 1 cm) përpara se t'i futni në kanë.


- 3** Vendosni përbërësit në kanë.



- 4** Shtypni sitën në kapakun e kanës.




- 5** Vendosni kapakun në kanë dhe kthejeni atë në drejtim orar për ta mbyllur mirë.






Shënim

- Kana ka vjaska që ndihmojnë në drejtimin e duhur të kunjave fiksuese dhe puthitjen e kapakut në vend. Sigurohuni që veshi i kapakut të rrëshqasë në dorezën e kanës.




- 6** Vendosni kanën në njësinë kryesore me kapakun në pjesën e sipërme, drejtvendosni ikonën  në kanë me ikonën  në njësinë kryesore dhe kthejeni kanën në drejtim orar për ta mbërthyer atë mirë në njësinë kryesore. Sigurohuni që doreza të jetë në anën e djathtë.



- Kur kana të jetë mbërthyer siç duhet në njësinë kryesore, ikona  në kanë do të drejtvendoset me ikonën  në njësinë kryesore.


- 7** Shtypni dhe mbani shtypur butonin e përzierjes për të filluar përzierjen, derisa ushqimi të jetë përzier siç duhet.



Kujdes

- Mos e lini pajisjen të përziejë për më shumë se 30 sekonda për rast. Nëse nuk keni mbaruar përzierjen pas 30 sekondave, lëshoni butonin për të ndaluar përzierjen dhe prisni pak sekonda përpara se të vazhdoni. Nëse njësia kryesore bëhet e nxehtë, lëreni të ftohet për disa minuta para se të vazhdoni.

8 Kur të keni përfunduar përzierjen, lëshoni butonin e përzierjes.



9 Hiqeni pajisje nga priza.

10 Hiqeni njësinë e teheve. Bëni kujdes kur hiqni helikën pasi mund të jetë e nxehtë. Hiqni ushqimin e përzier nga kana. Nëse është e nevojshme, përdorni shpatullën e përfshirë me këtë pajisje.

Ringrohja


Me pajisjen vjen një enë ruajtëse 120 ml. Përdorni enën ruajtëse për të ringrohur ushqimin për fëmijë që keni bërë me pajisjen.

Shënim

- Gjithmonë vendosni ushqim të përzier më parë në enën ruajtëse për ta ringrohur.
- Sigurohuni që gomina të jetë montuar rreth kapakut të kanës para ringrohjes dhe që ana e sheshtë e gominës të jetë nga jashtë.


1 Hidhni 160 ml ujë në depozitën e ujit (d.m.th. në shenjën e nivelit të ujit për 10/15 min).

2 Vendosni kapakun në depozitën e ujit dhe kthejeni atë në drejtimin orar për ta fiksuar mirë në vend.




- ↳ Kur kapaku i depozitës së ujit të jetë mbërthyer siç duhet në vend, ikona ▲ në kapakun e depozitës së ujit do të drejtvendoset me ikonën 🔒 në depozitën e ujit.


3 Nxirrni njësinë e teheve nga kana.



- 4** Ktheni enën ruajtëse përmbys dhe vendoseni atë në mbajtësen e njësisë së teheve në kanë.




- 5** Vendosni kapakun në kanë dhe kthejeni atë në drejtim orar për ta mbyllur atë mirë.




Shënim


- Kana ka vjaska që ndihmojnë në drejtimin e duhur të kunjave fiksuese dhe puthitjen e kapakut në vend. Sigurohuni që veshi i kapakut të rrëshqasë në dorezën e kanës.



- 6** Ktheni kanën përmbysë me kapakun e saj në pjesën e poshtme.




- 7** Drejtvendosni bashkuesin në kapakun e kanës me zonën e mbërthimit në depozitën e ujit dhe më pas vendoseni kanën në njësinë kryesore me kapakun në pjesën e poshtme. Shtyni kanën poshtë për ta mbërthyer atë fortë në njësinë kryesore dhe sigurohuni që doreza të jetë në anën e djathtë.




Shënim


- Sigurohuni që kapaku i depozitës së ujit të jetë mbërthyer mirë para se të vendosni kanën në njësinë kryesore.
- 8** Nëse çelësi i komandimit nuk është në pozicionin e fikjes (**OFF**), fillimisht kthejeni atë në pozicionin e fikjes.
- 9** Futni pajisjen në prizë.
- 10** Ktheni çelësin e komandimit për të zgjedhur kohën e ngrohjes që përputhet me enën ruajtëse të vendosur në kanë.



- Zgjidhni 15 minuta ().
- Llamba e avullimit  do të bëhet e bardhë për të treguar që pajisja po nxehet.
- 11** Kur cikli i ringrohjes të ketë mbaruar, pajisja do të lëshojë tingullin bip dhe llamba e avullimit  do të fiket.
- 12** Kthejeni sërish çelësin e komandimit në pozicionin e fikjes (**OFF**). Përpara se të hiqni kanën, prisni 2 minuta ose derisa nga pjesa e sipërme e pajisjes të mos dalë më avull.



- 13** Hapni kapakun e kanës dhe përdorni grepin e spatulës për të nxjerrë enën ruajtëse jashtë.




- 14** Mund të ketë ende ujë të mbetur në depozitën e ujit pas një cikli ringrohjeje. Kjo është normale. Prisni derisa pajisja të ftohet në temperaturë ambiente, më pas zbrazeni të gjithë ujin e mbetur nga depozita. Për të zbrazur ose për të pastruar depozitën e ujit, shihni kapitullin "Pastrimi dhe heqja e çmërsit".

Shkrirja

Nëse keni përdorur enët speciale ruajtëse për të ngrirë ushqimin e përzier, mund ta përdorni pajisjen për të shkrirë lehtë ushqimin e ngrirë.


Shënim

- Gjithmonë vendosni ushqim të përzier më parë në enën ruajtëse për ta shkrirë.
 - Sigurohuni që gomina të jetë montuar rreth kapakut të kanës para shkrirjes dhe që ana e sheshtë e gominës të jetë nga jashtë.
- 1** Mbusheni depozitën e ujit deri në shenjën MAX të nivelit të ujit që tregohet në anë të depozitës së ujit ose deri në treguesin MAX të nivelit të ujit në depozitën e ujit.
- 2** Ndiqni hapat 2 deri në 8 në kapitullin "Ringrohja".
- 3** Kthejeni çelësin e kontrollit dhe zgjidhni 30 minuta ❄️.




- ➡️ Llamba e avullimit  do të bëhet e bardhë për të treguar që pajisja po shkrin.
- 4** Kur cikli i shkrirjes të ketë mbaruar, pajisja do të lëshojë tingullin bip dhe llamba e avullimit  do të fiket.

- 5** Kthejeni sërish çelësin e komandimit në pozicionin e fikjes (**OFF**). Përpara se të hiqni kanën, prisni 2 minuta ose derisa nga pjesa e sipërme e pajisjes të mos dalë më avull.



- 6** Hapni kapakun dhe përdorni grepin e spatulës për të nxjerrë enën ruajtëse jashtë.



- 7** Mund të ketë ende ujë të mbetur në depozitën e ujit pas një cikli shkrirjeje. Kjo është normale. Prisni derisa pajisja të ftohet në temperaturë ambiente, më pas zbrazeni të gjithë ujin e mbetur nga depozita. Për të zbrazur ose për të pastruar depozitën e ujit, shihni kapitullin "Pastrimi dhe heqja e çmërsit".



Shënim

- Shkrini vetëm një herë të njëjtin grup ushqimi.
- Pas shkrirjes, rekomandojmë të kryeni një cikël tjetër ringrohjeje për ta ngrohur plotësisht ushqimin.

Përbërësit dhe koha e avullimit

Lloji i ushqimit	Përbërësi	Koha e përafërt e avullimit (min.)*	Niveli i ujit në depozitën e ujit (ml)
Fruta	Mollë	15	160
	Portokall/mandarinë	15	160
	Pjeshkë	10	160
	Dardhë	15	160
	Ananas	20	200
	Kumbull	10	160
	Luleshtrydhe	15	160
Perime	Shpargull	15	160
	Brokoli	15	160
	Karotë	20	200
	Lulelakër	15	160
	Selino	15	160
	Patëllxhan	15	160
	Finok	15	160
	Bishtaja	20	200
	Presh	15	160
	Qepë	15	160
	Bizele	15	160
	Spec zile	15	160
	Patate	20	200
	Kungull	15	160
	Spinaq	15	160
	Rrepë suedeze	15	160
	Misër i ëmbël	15	160
	Patate e ëmbël	15	160
	Domate	15	160
	Rrepë	15	160
	Kungull	15	160
Mish	Mish pule, viçi, qengji, derri etj.	20	200
Peshk	Salmon, merluc, shojzë, troftë etj.	15	160

* Koha e avullimit mund të ndryshojë. Koha e përafërt bazohet në prerjen e të gjithë përbërësve në kuba të vegjël, jo më të mëdhenj se 1 cm dhe me një peshë totale prej 250 g.

Pastrimi dhe deskorjezimi

Pastrimi



Kujdes


- Pastrojeni pajisjen pas çdo përdorimi.
- Mos e zhysni asnjëherë njësinë kryesore në ujë. Mos e shpëlani asnjëherë njësinë kryesore me ujë rubineti.
- Mos përdorni kurrë klor apo solucione sterilizimi kimik/tableta në pajisje.
- Mos përdorni kurrë sfungjerë gërvishtës, solucione abrazive apo lëngje ose lëngje agresive si p.sh. benzinë, aceton apo alkool për të pastruar pajisjen.




Shënim

- Të gjitha pjesët përveç njësisë kryesore mund të pastrohen dhe në enëlarëse.
- Gjithmonë montoni unazën mbyllëse rreth kapakut të kanës pasi ta keni hequr për pastrim, dhe sigurohuni që ana e sheshtë e unazës mbyllëse të jetë nga jashtë.


- 1** Hiqeni pajisjen nga priza dhe largoni kanën nga njësia kryesore.




- 2** Shtyni veshin e kapakut në drejtim kundërorar për të hequr kapakun nga kana.




- 3** Kapni pjesën e dalë nga sita dhe fillimisht tërhiqni njërën anë të sitës jashtë dhe më pas hiqni sitën nga kapaku i kanës.



- 4** Çmontoni gominën nga kapaku i kanës për ta pastruar kurdo që të jetë e nevojshme.
- 5** Hiqeni njësinë e teheve.




- 6** Pastroni mirë njësinë e teheve me ujë rubineti menjëherë pas përdorimit. Sigurohuni që të shpëlani gjithashtu edhe pjesën e brendshme të tubit të njësisë së teheve.





Kujdes

- Manovrojeni helikën me shumë kujdes. Tehet prerëse janë shumë të mprehta.
- 7** Ktheni kapakun e depozitës së ujit në drejtim kundërorar dhe hiqeni atë nga depozita e ujit.



- 8** Lani kapakun e depozitës së ujit me ujë rubineti.

- 9** Derdhni jashtë ujin e mbetur në depozitë. Nëse është e nevojshme, hidhni ujë të freskët në depozitën e ujit dhe derdhjeni atë jashtë. Përsëriteni sipas nevojës derisa depozita e ujit të jetë e pastër.




- 10** Pastroni të gjitha pjesët e tjera që kanë rënë në kontakt me ushqimin, me ujë të nxehtë e me detergjent, menjëherë pas përdorimit.
- 11** Thani njësinë kryesore dhe të gjitha pjesët pas larjes.

Zhëlgërëzimi i depozitës së ujit

Për performancë optimale, ne rekomandojmë zhëlgërëzimin e pajisjes çdo 4 javë. Për të zvogëluar akumulimin e çmërsit, rekomandojmë përdorimin e ujit të butë ose të demineralizuar për avullim, ringrohje ose shkrirje.



Për të hequr çmërsin nga pajisja, ndiqni udhëzimet e mëposhtme për heqjen e çmërsit.

- 1** Sigurohuni që pajisja të jetë fikur.
- 2** Për të hequr çmërsin nga depozita e ujit, përzieri 80 ml uthull të bardhë (6 % acid acetik) me 80 ml ujë, ose mund të përdorni acid citrik me ujë të ngrohtë.
- 3** Shtoni solucionin te boileri në depozitën e ujit.
- 4** Vendosni kapakun në depozitën e ujit dhe kthejeni atë në drejtimin orar për ta fiksuar mirë në vend.
- 5** Prisni 6 orë/gjithë natën ose derisa të jetë shpërbërë i gjithë çmërsi.
- 6** Derdhni solucionin e përdorur nga depozita e ujit.



- 7** Nëse shtresa e krijuar e çmërsit nuk është shpërbërë plotësisht, përsëriteni ciklin e heqjes së çmërsit nga hapi 1 deri në 6 në këtë kapitull.


- 8** Hidhni pak ujë të freskët në depozitën e ujit dhe derdhjeni atë jashtë. Përsëriteni sipas nevojës derisa depozita e ujit të jetë e pastër.



- 9** Shpëlani mirë kapakun e depozitës së ujit me ujë rubineti.
- 10** Mbushni depozitën e ujit me 200 ml ujë dhe lëreni pajisjen të përfundojë një cikël avullimi 20-minutësh me kanën bosh para se ta përdorni përsëri pajisjen me ushqim.

Vendruajtja

- 1** Zbrazeni depozitën e ujit para se ta ruani pajisjen.



- 2** Sigurohuni që të gjitha pjesët të jenë të pastra dhe të thata përpara se ta ruani pajisjen (shihni kapitullin "Pastrimi dhe heqja e çmërsit").
- 3** Ruajeni pajisjen me njësinë e teheve në kanë për të parandaluar dëmtimin.
- 4** Sigurohuni gjithmonë që kapaku i depozitës së ujit dhe i kanës të jenë mbërthyer siç duhet për të ruajtur pajisjen.

Riciklimi



Ky simbol do të thotë që produktet elektrike nuk duhet të hidhen me mbeturinat e zakonshme të shtëpisë.

Zbatoni rregulloret e shtetit tuaj për grumbullimin e veçuar të produkteve elektrike.

Mbështetja

Për mbështetje për të gjitha produktet, si pyetjet më të shpeshta, vizitoni www.philips.com/support.



Shënim

- Konsumi i energjisë (modaliteti i pritjes): <0,5 W (kohë deri në modalitetin automatik të pritjes: <1 min).

Zgjidhja e problemeve

Ky kapitull përmbledh problemet më të shpeshta që mund të hasni me pajisjen. Nëse nuk keni mundësi ta zgjidhni problemin me informacionin e mëposhtëm, kontaktoni me qendrën e kujdesit për klientin në vendin tuaj.

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
Pajisja nuk punon.	Kjo pajisje ka një siguresë. Kjo pajisje nuk do të funksionojnë nëse pjesët nuk janë montuar siç duhet në njësinë kryesore.	Montojini të gjitha pjesët ashtu siç duhet. Përpara procesit të avullimit, kana duhet të vendoset vertikalisht në njësinë kryesore, me kapakun e kanës në pjesën e poshtme; përpara përzierjes, vendoseni kanën në njësinë kryesore, me kapakun në pjesën e sipërme dhe mbërthejeni kanën duke e kthyer atë në drejtim orar.
 Drita e avullimit nuk ndizet.	Pajisja nuk është lidhur me burimin e energjisë.	Futni spinën në prizë.
	Kana nuk është vendosur siç duhet në njësinë kryesore.	Vendoseni siç duhet kanën në njësinë kryesore, me kapakun e kanës në pjesën e poshtme.
	Keni filluar një cikël të dytë avullimi menjëherë pasi cikli i parë ka përfunduar.	Fikni pajisjen dhe lëreni atë të ftohet për 10 minuta para se të filloni një cikël të dytë avullimi.
Depozita e ujit lëshon një aromë të pakëndshme herët e para të përdorimit.	Çelësi i komandimit nuk është kthyer në pozicionin e fikjes (OFF) pas përfundimit të ciklit të mëparshëm të avullimit.	Fillimisht ktheni çelësin e komandimit në pozicionin e fikjes (OFF) dhe më pas kthejeni atë sërish për të zgjedhur kohën e funksionimit.
	Nuk e keni larë paraprakisht depozitën e ujit përpara përdorimit.	Shihni kapitullin "Pastrimi dhe heqja e çmërsit" për të pastruar depozitën e ujit dhe më pas përfundoni ciklin e avullimit me kanën bosh.
Pajisja nuk lëshon avull.	Nuk keni hedhur ujë në depozitën e ujit.	Fikni dhe hiqeni pajisjen nga priza dhe më pas shtoni ujë në depozitë.

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
	Në depozitën e ujit është krijuar shumë çmërs.	Hiqni çmërsin nga depozita e ujit. Shihni seksionin "Heqja e çmërsit" në kapitullin "Pastrimi dhe heqja e çmërsit".
Depozita e ujit po nxjerr avull.	Kapaku i depozitës së ujit nuk është mbyllur siç duhet.	Mbyllni siç duhet kapakun e depozitës së ujit. Sigurohuni që ikona ▲ në kapakun e depozitës së ujit të jetë e drejtvendosur me ikonën 🔒 në depozitën e ujit.
	Kana nuk është vendosur siç duhet në njësinë kryesore.	Vendosni siç duhet kanën në njësinë kryesore.
	Dalja e avullit në kapakun e depozitës së ujit është e bllokuar për shkak të ndotjes ose krijimit të çmërsit.	Pastroni daljen e avullit në kapakun e depozitës së ujit.
	Hyrja e avullit në kapakun e kanës është e bllokuar për shkak të ndotjes.	Pastroni hyrjen e avullit në kapakun e kanës.
Përbërësit nuk janë ngrohur plotësisht.	Copat në kanë janë shumë të mëdha.	Priteni ushqimin në copa më të vogla (kuba jo më të mëdhenj se 1 cm).
	Sasia e ushqimit në kanë është shumë e madhe.	Reduktoni sasinë e ushqimit në kanë.
	Sasia e ujit në depozitën e ujit është shumë e vogël ose shumë e madhe.	Shtoni sasinë e duhur të ujit sipas kohës së avullimit. Kontrolloni broshurën me receta dhe/ose tabelën në kapitullin "Përbërësit dhe koha e avullimit" për t'u siguruar që të shtoni sasinë e duhur të ujit sipas kohës së avullimit për përbërësit që dëshironi të përgatitni në avull ose për recetën që dëshironi të përgatisni.
	Koha e avullimit është shumë e shkurtër.	Zgjidhni një kohë më të gjatë avullimi (maksimumi 30 minuta).
	Kana nuk është vendosur siç duhet në njësinë kryesore.	Vendoseni siç duhet kanën në njësinë kryesore, me kapakun e kanës në pjesën e poshtme.
	Në depozitën e ujit është krijuar shumë çmërs.	Hiqni çmërsin nga depozita e ujit. Shihni seksionin "Heqja e çmërsit" në kapitullin "Pastrimi dhe heqja e çmërsit".
Nga kapaku i kanës ka rrjedhje.	Sasia e ushqimit në kanë është shumë e madhe.	Fikeni pajisjen dhe përpunoni një sasi më të vogël.

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
	Kapaku i kanës nuk është mbërthyer siç duhet në kanë.	Vendosni kapakun në kanë dhe kthejeni atë në drejtim orar për ta mbyllur atë mirë.
	Gomina rreth kapakut të kanës nuk është vendosur ose nuk është vendosur saktë.	Sigurohuni që gomina të jetë vendosur siç duhet rreth kapakut të kanës, me anën e sheshtë nga jashtë.
Funksioni i përzierjes nuk funksionon.	Sasia e ushqimit në kanë është shumë e madhe.	Fikeni pajisjen dhe përpunoni një sasi më të vogël. Ushqimi i papërpunuar i futur në kanë nuk duhet të kalojë përtej njësisë së teheve.
	Kana nuk është vendosur siç duhet në njësinë kryesore.	Vendosni kanën në njësinë kryesore me kapakun në pjesën e sipërme, drejtvendosni ikonën  në kanë me ikonën  në njësinë kryesore dhe kthejeni kanën në drejtim orar për ta mbërthyer atë mirë në njësinë kryesore.
	Kapaku i kanës nuk është mbërthyer siç duhet në kanë.	Vendosni kapakun në kanë dhe kthejeni atë në drejtim orar për ta mbyllur atë mirë.
	Jeni duke e përdorur pajisjen për të përzierë ushqime të ngjithshme, si p.sh. djathë.	Kontrolloni broshurën me receta dhe përdorni përbërësit e duhur për t'i përzierë.
	E keni përdorur funksionin e përzierjes pa ndërprerje për më shumë se 30 sekonda.	Ndaloni përzierjen dhe lëreni pajisjen të ftohet për disa sekonda dhe më pas filloni sërish përzierjen.
Pajisja bën shumë zhurmë, lëshon një aromë të pakëndshme, është e nxehtë kur e prek, nxjerr tym etj.	Sasia e ushqimit në kanë është shumë e madhe.	Fikeni pajisjen dhe përpunoni një sasi më të vogël.
	E keni përdorur funksionin e përzierjes për shumë kohë.	Mos e lini pajisjen të përziejë pa ndërprerje për më shumë se 30 sekonda rresht.
Pajisja krijon shumë zhurmë dhe dridhje gjatë përzierjes.	Sita nuk është vendosur në kapakun e kanës.	Sigurohuni që sita të jetë fiksuar pas kapakut të kanës.

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
Temperatura e ushqimit të shkrire është ende e ulët.	Ka shumë ushqim në enën ruajtëse.	Sigurohuni që sasia e ushqimit në enën ruajtëse të mos e tejkalojë shkallën maksimale të shënuar në anë të enës.
	Ushqimi në enën ruajtëse është shumë i trashë.	Lëreni pajisjen të ftohet për 10 minuta dhe shkrijeni ushqimin sërish.
Ka rrjedhje nga ena ruajtëse gjatë ringrohjes/shkrijes.	Kapaku i enës ruajtëse nuk është mbyllur siç duhet.	Përpara se të vendosni enën ruajtëse në kanë për të ringrohur/shkrire ushqime, sigurohuni që kapaku të jetë mbyllur siç duhet.
Uji në depozitën e ujit ka ngjyrë të pazakontë kur e derdhni nga depozita ose kur e derdhni brenda në kanë gjatë avullimit, ose uji në depozitë ka një aromë të pakëndshme.	Grimca ushqimi kanë hyrë në depozitën e ujit gjatë përdorimit.	Pastroni depozitën e ujit sipas udhëzimeve në kapitullin "Pastrimi dhe heqja e çmërsit". Përdoreni pajisjen vetëm sipas udhëzimeve. Sigurohuni që të mos e tejmbushni depozitën e ujit me ujë (maks. 250 ml) dhe që të mos e tejmbushni kanë me ushqim (mos e mbushni kanë përtej skajit të sipërm të pjesës plastike të njësisë së teheve). Mos e zgjatni përgatitjen në avull të të njëjtëve përbërës për më shumë se 30 minuta ose mos shtoni lëng në kanë për të avulluar. Pasi të keni hedhur lëngje në kanë, mos e vendosni asnjëherë kanë në pozicionin e avullimit me kapakun e kanës në pjesën e poshtme.
Ka njolla në bardha në depozitën e ujit, në kapakun e depozitës së ujit, në kanë, në kapakun e kanës dhe në sitë.	Në këto pjesë është krijuar çmërs.	Kjo është normale. Hiqeni çmërsin rregullisht. Pastroni kapakun e depozitës së ujit, kanë, kapakun e kanës dhe sitën me një leckë të njomë. Hiqni çmërsin nga depozita e ujit. Shihni seksionin "Heqja e çmërsit" në kapitullin "Pastrimi dhe heqja e çmërsit".
Sipërfaqet që bien në kontakt me ushqimin janë çngjyrosur.	Ngjyruarit e ushqimeve mund të çngjyrosin pjesët të cilat bien në kontakt me ushqimin.	Kjo është normale. Të gjitha pjesët janë ende të sigurta për t'u përdorur dhe nuk do të dëmtojnë ushqimin e gatuar.

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
Pajisja lëshon 5 herë një tingull zanor dhe drita e avullimit pulson gjatë avullimit, ringrohjes apo shkrirjes.	Kana ka lëvizur nga pozicioni i saj ose është hequr nga njësia kryesore gjatë përpunimit.	Ktheni çelësin e komandimit në pozicionin e fikjes (OFF), kontrolloni sasinë e ujit në depozitë, vendoseni kanën siç duhet në njësinë kryesore dhe zgjidhni kohën e përpunimit për të filluar sërish.
	Uji në depozitë nuk është i mjaftueshëm për kohën e zgjedhur të përpunimit.	Fillimisht ktheni çelësin e komandimit në pozicionin e fikjes (OFF) dhe shtoni mjaftueshëm ujë për kohën e zgjedhur të përpunimit.
	Në depozitën e ujit është krijuar shumë çmërs.	Hiqni çmërsin nga depozita e ujit. Shihni seksionin "Heqja e çmërsit" në kapitullin "Pastrimi dhe heqja e çmërsit".
Ka mbetje ushqimi në shtresën e brendshme në pjesën e poshtme të kanës.	Grimcat e vogla të mbetjeve të ushqimeve hyjnë në shtresën e brendshme në pjesën e poshtme të kanës gjatë pastrimit.	Hiqni kanën nga njësia kryesore. Hiqni kapakun e kanës dhe njësinë e teheve nga kana. Ktheni kanën, drejtvendosni vrimën e vogël në pjesën e poshtme të saj në një rubinet dhe futni ujë në vrimën e vogël. Përdorni ujë të ngrohtë për të arritur rezultate më të mira pastrimi. Mbani dorezën e kanës dhe tundeni kanën për rreth 15 sekonda për të përzier ujin me mbetjet e akumuluar. Derdhni ujin nga vrima e vogël. Përsëritni hapat e mësipërm disa herë derisa mbetjet të jenë pastruar.

Specifikimet teknike

- Tensioni/fuqia: Shihni pllakën e modelit në pjesën e poshtme të pajisjes
- Kapaciteti maksimal i depozitës së ujit: 250 ml
- Kapaciteti maksimal i kanës: 1050 ml
- Temperatura e punës: 10°C deri në 40°C
- Mbrojtja: Sistem ngrohjeje me temperaturë të kontrolluar

